



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep.	DPK	Nr. Prot.	03-02/4326/16
Dep.		Prot. Nr.	
Nr. i faq.		Data	11.11.2016
Broj stranica	02	Data	
Nr. pages			

PRIS

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3368/16, për z. Miftar Zenelaj, Drejtor në Qendrën e Shëndetit Mendor të Shtimes, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Miftar Zenelaj, Drejtor në Qendrën e Shëndetit Mendor të Shtimes, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në bizneset private N.T.P “Power Swid” dhe Sh.P.K “INPK Prizreni”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Zenelaj është njoftuar se zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Prandaj, Agjencia kundër Korrupsionit i ka rekomanduar zyrtarit të lartë të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në bizneset private të lartë cekura në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do ti bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci një shkresat zyrtare (DPKI.03-02/4208/16) (DPKI.03-02/4209/16), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në bizneset private të lartë cekura.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

